



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 675/1 prot.

Tiranë më 11. 4 .2023

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË BRENDSHME


Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.3076/1 prot., datë 29.03.2023, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shprehet dakord me projektvendimin "*Për miratimin, në parim të Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi veprimtaritë operationale të kryera nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në Republikën e Shqipërisë*" dhe vlerëson se marrëveshja është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe reflekton në tërësi frymën e GDPR.

Megjithatë, duke marrë parasysh që kuadri ligjor i fushës është në fazë përafrimi me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian (*GDPR dhe Direktiva e Policisë*), sugjerojmë që, me qëllim unifikimin e terminologjisë me atë të parashikuar në projektligjin "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i hartuar në përputhje me këto akte, në germën f) të pikës 1 të nenit 16, termi "*shkelja e të dhënave personale*", të zëvendësohet me "*cënim i të dhënave personale*".

Gjithashtu, në pikën 3 dhe 4 të nenit 16 të marrëveshjes, termi "*Komisioneri për të Drejtën e Informacionit Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" të zëvendësohet me "*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



KOMISIONERI

Besnik Dervishi